

V E N D I M
Nr.421, datë 22.8.1994

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.291, DATË 21.6.1994 “PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË APARTAMENTEVE QË NDËRTOHEN ME FONDE SHTETËRORE”

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.291, datë 21.6.1994, pika 5 ndryshohet si vijon:
“Kur pagesa e apartamentit bëhet në mënyrë të menjëhershme, do të ketë një zbritje të çmimit prej 10 për qind”.
2. Pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:
“Ngarkohet Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit të nxjerrë udhëzimin përkatës për mënyrën e shpërndarjes së banesave dhe kategorinë e qytetarëve që do të përfitojnë banesë. Ky udhëzim do të zbatohet nga organet e pushtetit lokal dhe Entit Kombëtar i Banesave”.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi